



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
SENATI AKADEMIK



Nr. 2648/2 Prot.

Durrës, më 18.12. 2024

V E N D I M

Nr. 58, Datë 18. 12. 2024

PËR

"MIRATIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT STRATEGJIK PËR PERIUDHËN 2025-2030 TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 38 "Funksionet e Senatit Akademik" pika 1, gërmë "b"; në Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj"; në Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; në Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës neni 15 "Funksionet e Senatit Akademik" pika 1, gërmë "d"; në Urdhrin e Rektorit Nr. 428, datë 04.10.2024 për "Ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Zhvillimit Strategjik 2025-2030 të UAMD-së", në mbledhjen e datës 18.12.2024 Senati Akademik i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Planit të Zhvillimit Strategjik për periudhën 2025-2030 të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i kalon për aprovim Bordit të Administrimit.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS



# Plani i zhvillimit strategjik 2025 – 2030



## Grupi i Punës për Hartimin e Planit Strategjik

Ky grup u krijua me Urdhër të Rektorit Nr. 428, Datë. 04.10.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të zhvillimit strategjik 2025-2030 të UAMD". Për të garantuar një përfaqësim të gjerë dhe të balancuar të njësive akademike dhe administrative, u kërkuan sygjerime nga dekanët e fakulteteve, duke siguruar që grupi të ishte gjithëpërfshirës. Grupi i punës kishte për detyrë të organizonte dhe të udhëhiqte procesin e hartimit të planit strategjik. Funksionet e grupit përfshinin mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për të identifikuar nevojat dhe mundësitet strategjike të UAMD, zhvillimin e konsultimeve me palët e interesit dhe krijimin e dokumenteve analitike dhe propozimeve për strategjinë.

### Grupi i Punës:

Azeta Tartaraj

Kryetare

Menada Petro

Anëtare

Aida Lako (Zotaj)

Anëtare

Amarildo Rista

Anëtar

Dorina Gjipali

Anëtare

Edlira Llazo

Anëtare



## Përbajtja

Fjala e Rektorit.....	3
Hyrje .....	4
Vizioni, misioni dhe vlerat.....	6
Konteksti aktual.....	8
Analiza SWOT.....	15
Prioritetet strategjike.....	17
Prioriteti 1: Mësimdhënia dhe studentët .....	18
Prioriteti 2: Kërkimi shkencor dhe Inovacioni .....	20
Prioriteti 3: Ndërkombëtarizimi .....	24
Prioriteti 4: Infrastruktura dhe burimet njerëzore .....	29
Prioriteti 5: Komuniteti dhe përgjegjësia sociale .....	33
Prioriteti 6: Qeverisja dhe trasparenca .....	39
Monitorimi i planit të zhvillimit .....	40
Rishikimi dhe përmirësimi i planit .....	40
Anekse.....	41



## Fjala e Rektorit


Plani i Zhvillimit Strategjik 2025-2030 i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës shërben si një udhërrëfyes për të ardhmen e Institucionit tonë, duke përcaktuar vizionin që e udhëheqin, si dhe objektivat strategjike që synojmë të arrijmë. Plani nuk është thjesht një dokument, por dëshmi e përkushtimit tonë të plotë për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë në të gjitha sferat universitare dhe përshtatje me dinamikat e shpejta kombëtare e ndërkombëtare. Ai, përcakton qartësisht prioritetet dhe objektivat strategjike, që synojnë forcimin e rolit të Universitetit për një edukim cilësor, kërkim e shkencor dhe shërbim ndaj komunitetit, por edhe thellimin e lidhjeve me partnerët lokal e ndërkombëtarë. Reflekton veçoritë dalluese të UAMD-së si një institucion i përkushtuar ndaj standardeve akademike dhe që ka për qëllim fuqizimin e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore për një ndikim më të madh në shoqerinë shqiptare.

Procesi i hartimit të këtij plani është fryt i kontributit të vyer, i të gjithë stafi akademik, që është edhe vlera më e çmuar e universitetit tonë. Ai është realizuar bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes dhe transparencës. Struktura dhe përbajtja e tij janë produkt i analizave të arritjeve të mëparshme dhe konsultimeve me komunitetin e UAMD-së. Angazhimi i përbashkët ka siguruar një panoramë mbi nevojat dhe pritshmëritë për të ardhmen.

Plani i Zhvillimit Strategjik 2025-2030 nuk është vetëm një dokument formal. Ai përfaqëson një angazhim moral dhe profesional të Universitetit tonë për të arritur më të mirën në çdo aspekt të veprimit tarisë së tij. Na udhëzon drejt qëllimeve të përbashkëta edhe për dekadën e ardhshme, duke nxitur një fryshtë bashkëpunimi ndërmjet strukturave tona akademike dhe administrative. UAMD synon të forcojë pozicionin e tij si një institucion lider në rajon, duke u shndërruar në një model për integrimin e dijes, inovacionit dhe shërbimit ndaj komunitetit. Ne besojmë, se ky vizion do të realizohet përmes punës sonë të përbashkët dhe përkushtimit për një të ardhme më të mire, për studentët tanë dhe për shoqërinë shqiptare në tërësi.

Në vigilje të 20 vjetorit të themelimit të UAMD-së, është momenti për të reflektuar mbi arritjet tona, për të avancuar përpara e për të ndërtuar së bashku rrugë të qëndrueshme drejt të ardhmes. Përmes Planit Strategjik 2025-2030, ne jemi besimplotë se do përfaqësohem denjësisht e do marrim një rol aktiv të rëndësishëm në hapësirën akademike evropiane dhe më gjërë.

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi  
Rektor i UAMD



## Hyrje


Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD) është një institucion publik i arsimit të lartë, që synon të kontribuojë në zhvillimin arsimor, shkencor dhe social-ekonomik në Shqipëri dhe më gjërë. Në një periudhë dinamike dhe sfiduese për shoqërinë, roli i institucioneve të arsimit të lartë si UAMD është gjithnjë e më i rëndësishëm. Universiteti nuk është vetëm një burim i dijes për gjeneratat e reja, por gjithashtu një kontribues i fuqishëm në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të shoqërisë. Duke u përballur me sfidat e një tregu pune gjithnjë e më global dhe të ndërlidhur, në një ekonomi të orientuar drejt dijes dhe teknologjisë, Universiteti "Aleksandër Moisiu" synon të ndërtojë një platformë të qëndrueshme dhe inovative për edukim të cilësisë së lartë dhe kërkime shkencore, në përputhje me kërkosat e kohës dhe që ndihmojnë në përmirësimin e mirëgenies kolektive.

Plani i Zhvillimit Strategjik i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës për periudhën 2025-2030 pasqyron përkushtimin e universitetit për të arritur objektiva të qarta dhe ambicioze. Kjo strategji përvijon qartë objektivat e strategjisë së zhvillimit 2020-2025 duke synuar arritjen e standardeve të larta të cilësisë akademike dhe zhvillimin e një qasje gjithëpërfshirëse që lidh arsimin, kërkimin dhe inovacionin me nevojat konkrete të tregut të punës, por dhe të komunitetit më të gjërë. Plani i Zhvillimit Strategjik ka për qëllim forcimin e identitetit të UAMD-së si një institucion autonom, bashkëkohor dhe të angazhuar në përbushjen e misionit të tij. Ai synon të krijojë, një mjeshtësi arsimor gjithëpërfshirës që mbështet zhvillimin e talenteve dhe integrimin efektiv të tyre në ekonominë e dijes, përmes zhvillimit të një rrjeti të gjërë bashkëpunimesh ndërkombëtare dhe ndërsektoriale. Plani i Zhvillimit Strategjik i UAMD-së është hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) të OKB-së dhe Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029. Ky plan synon përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë, përgatitjen e studentëve për tregun global të punës dhe promovimin e partneritetave ndërkombëtare. Gjithashtu, përqëndrohet në përdorimin e teknologjisë dhe inovacionit, krijuimin e një mjeshtësi gjithëpërfshirës dhe mbështetës, si dhe nxitjen e barazisë gjinore dhe sociale. Përmes këtij angazhimi, UAMD kontribuon në një sistem arsimor të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.



## UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS

Universiteti, synon të luajë një rol kyç në arritjen e qëllimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, përmes bashkëpunimit me aktorë lokal dhe global. Përmes veprimeve të tij, UAMD mbështet SDGs si arsimi cilësor (SDG 4), barazia gjinore (SDG 5), dhe inovacioni (SDG 9), duke kontribuar gjithashtu në fuqizimin e të rinjve në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Rinisë. Përmes programeve të studimit dhe projekteve kërkimore, Universiteti syon të nxisë zhvillimin e aftësive professionale dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve në përballjen e sfidave globale, duke ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme për komunitetin dhe shoqërinë shqiptare.



## Vizioni, misioni dhe vlerat

### Vizioni

Universiteti "Aleksandër Moisiu" synon të pozicionohet si një qendër ekselente e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Shqipëri dhe në rajon, duke shërbyer si një model i inovacionit dhe i përkushtimit akademik ndaj cilësisë. Universiteti aspiron të jetë një institucion i dalluar, për rolin e tij në krijimin dhe transferimin e dijes, që ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të komunitetit. Vizioni ynë përfshin angazhimin për të përgatitur profesionistë të aftë për të përballuar sfidat komplekse të tregut të punës global, duke kontribuar në krijimin e një "ekonomie të dijes" dhe duke nxituar një kulturë të qëndrueshme të përparimit intelektual dhe profesional. Ne synojmë të ndërtojmë një universitet të pavarur, inovativ dhe të orientuar drejt kërkimit shkencor me vlerë të lartë, që fuqizon studentët dhe stafin akademik të kontribuojnë në mënyrë të përgjegjshme dhe me integritet në shoqëri. Universiteti do të vazhdojë të jetë pararojë në mësimdhënie dhe hulumtim ndërkombëtar, duke udhëhequr një komunitet të edukuar dhe të ndërgjegjshëm që i përgjigjet kërkkesave të një shoqërie të globalizuar, por edhe sfidave të bashkësisë akademike ndërkombëtare.

### Misioni

Misioni i Universitetit "Aleksandër Moisiu" është të ofrojë edukim të lartë dhe gjithëpërfshirës, duke nxituar formimin e një komuniteti akademik të përkushtuar ndaj shkencës, kreativitetit dhe inovacionit. Përmes ofertës së programeve të avancuara në të tre ciklet e studimit dhe programeve të formimit gjatë gjithë jetës, Universiteti synon të krijojë mundësi për zhvillim të vazhdueshëm për studentët dhe stafin akademik. Misioni ynë është të nxisim një kulturë kërkimore që promovon përmbushjen e standardeve më të larta shkencore dhe inkurajon përfshirjen aktive në projekte të cilat krijojnë ura bashkëpunimi midis tregut të punës dhe akademisë. Në një epokë të globalizuar, UAMD angazhohet të forcojë ndërkombëtarizimin përmes partneriteteve me institucione



prestigjoze, duke ofruar një platformë të hapur për shkëmbimin e dijes dhe për inovacionin në arsim.

Si një qendër e rëndësishme e dijes dhe zhvillimit të potencialit intelektual, Universiteti do të mbështesë zhvillimin e studentëve në mënyrë që ata të kontribuojnë si qytetarë aktiv dhe të ndërgjegjshëm. Nëpërmjet promovimit të projekteve dhe aktiviteteve shkencore që ndërtharin teorinë me praktikën, Universiteti synon të krijojë një ambient frysues që garanton përgatitjen e të diplomuarve për përbushjen e kërkesave të tregut të punës dhe për angazhimin e tyre në transformimin pozitiv të shoqërisë. Ne synojmë të sigurojmë një mjedis të stimuluar nga respekti, ndershmëria dhe integriteti, duke promovuar në këtë mënyrë zhvillimin personal dhe profesional të studentëve dhe stafit akademik, me qëllim krijimin e një komuniteti akademik të fuqishëm dhe të integruar.


## Vlerat

Universiteti “Aleksandër Moisiu” bazohet në një tërësi vlerash që formojnë identitetin e tij akademik. Në themel të këtij identiteti qëndron liria akademike, e cila inkurajon krijimin dhe diskutimin e ideve të reja. Autonomia institucionale siguron pavarësi në vendimmarrje dhe orientimin drejt një zhvillimi të qëndrueshëm të universitetit.

Integriteti është një parim thelbësor që udhëheq të gjitha veprimtarinë e universitetit, duke ndihmuar në ndërtimin e një kulture besimi dhe përgjegjësie. Përkushtimi ndaj cilësisë është një tjetër aspekt i rëndësishëm, që synon ofrimin e një arsimimi bashkëkohor dhe promovimin e kërkimit shkencor me standarde etike.

Vlerat e universitetit mbështeten mbi parimet e përgjithshme të së drejtës të përcaktuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që sigurojnë respektimin e dinjitetit njerëzor dhe barazisë. Statuti i UAMD-së përcakton rregullat e funksionimit, duke inkurajuar pluralizmin e ideve dhe mbarëvajtjen në proceset mësimore dhe kërkimore.

Në këtë kontekst, Universiteti synon të krijojë një ambient ku respektohen të drejtat dhe liritet e individëve, duke promovuar një kulturë që mbështet zhvillimin personal dhe profesional të çdo anëtari të komunitetit akademik.



## Konteksti aktual

Universiteti "Aleksandër Moisiu" i Durrësit (UAMD) përfaqëson një nga institucionet më të reja dhe të rëndësishme arsimore në Shqipëri. Themeluar në vitin 2005 dhe i hapur për studentët në vitin akademik 2006-2007, UAMD ka shërbyer si një qendër për përgatitjen akademike dhe profesionale të të rinjve në Shqipëri dhe rajon. I vendosur në qytetin historik të Durrësit, një nga qytetet më të vjetra dhe më të rëndësishme në Ballkan, Universiteti kombinon trashëgiminë kulturore të qytetit me ambicjet për arsim dhe zhvillim të teknologjisë moderne.

Me mbi 17,000 studentë të regjistruar, UAMD është një nga institucionet më të rëndësishme të arsimit të lartë në Shqipëri. Universiteti ka dy kampuse dhe ofron mbi 100 programe studimi, duke e bërë atë një qendër të rëndësishme për kërkimin shkencor dhe për mësimdhënien cilësore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

UAMD ofron programe studimi të nivelit Bachelor, Master, Doktoraturë dhe programe profesionale 2-vjeçare në pesë fakultetet, çka reflekton diversitetin e disiplinave të ofruara, duke i mundësuar studentëve të zgjedhin rrugë akademike të përshtatshme për interesat dhe ambicjet e tyre profesionale, si dhe për të plotësuar nevojat e tregut të punës.

Në këtë mënyrë, UAMD është pozicionuar jo vetëm si një qendër e rëndësishme akademike në nivel kombëtar, por edhe si një partner kyç në rrjetet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe zhvillimit të inovacionit, duke përbushur objektivat strategjike të universitetit përritje dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Stafi akademik i UAMD-së, i përbërë nga mbi 500 anëtarë, përfshin profesorë, profesorë të asociauar, lektorë dhe asistentë lektorë. Stafi përfaqëson një burim të rëndësishëm ekspertize dhe përkushtimi ndaj cilësisë akademike, duke siguruar një mjedis të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor që u përgjigjet nevojave të kohës. Përmes



## UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

përfshirjes së tyre aktive në programe akademike dhe kërkimore, universiteti synon të krijojë një kulturë akademike që inkurajon inovacionin, zhvillimin profesional dhe përmirësimin e vazhdueshëm të arsimit të lartë.

Ndërkombëtarizimi është një prioritet, i cili evidentohet dhe nga marrëveshjet ndërinstitucionale dhe projektet e finançuara nga Bashkimi Evropian. Për shembull, programet e diplomave të dyfishta dhe projektet e shumta me partnerë ndërkombëtarë. Në kuadër të bashkëpunimeve ndërkombëtare, UAMD ka nënshkruar 179 marrëveshje ndërinstitucionale. Aktualisht drejton 21 projekte të finançuara nga Bashkimi Evropian, duke kontribuar në rritjen e vizibilitetit të universitetit në arenën ndërkombëtare dhe përfshirjen e tij në projekte të rëndësishme zhvillimi. Këto bashkëpunime dhe projekte kanë ndihmuar në zgjerimin e horizontit të stafit akademik, gjithashtu duke i dhënë mundësinë studentëve për të përfituar nga përvoja ndërkombëtare dhe për t'u përgatitur për karriera të suksesshme në kontekste globale.

Të dhënat mbi studentët e diplomuar reflektojnë një shpërndarje të larmishme në nivel arsimor, me shumicën e studentëve që përfundojnë studimet Bachelor dhe Master, ndërsa një pjesë më e vogël ndjekin studimet profesionale dhe doktoraturën. Universiteti përqendrohet në krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës dhe të barabartë, ku 57% e studentëve të diplomuar janë femra, duke pasqyruar një qasje të ekuilibruar gjinore. Po ashtu, 69% e stafit akademik dhe administrativ janë femra, duke treguar përkushtimin e universitetit ndaj fuqizimit të grave në akademi dhe administratë.

Universiteti "Aleksandër Moisiu" është i përkushtuar për të zhvilluar një strategji afatgjatë të zhvillimit që mbështetet në ofrimin e programeve të arsimit cilësor, fuqizimin e stafit akademik dhe zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare. Këto elemente janë thelbësore për të vazduar përmirësimin e ndikimit të tij në komunitetin lokal dhe ndërkombëtar, si dhe për t'i ofruar studentëve mundësi të larmishme arsimore dhe profesionale.

### Analiza e Pozicionimit të UAMD

Analiza e pozicionimit të UAMD-së është thelbësore për të formuluar një strategji të qartë dhe të bazuar në realitet. Kjo analizë ndihmon në vlerësimin e situatës aktuale të universitetit duke ekzaminuar kontekstin e brendshëm dhe të jashtëm.

Duke patur në konsideratë limitet e brendshme dhe sfidat e jashtme, si dhe pikat e forta dhe mundësitë që duhen shfrytëzuar, është e mundur të identifikohen faktorët kritikë të suksesit. Këto do të formojnë bazën për një planifikim strategjik të realizueshëm dhe



konkret për UAMD, që synon të forcojë pozicionin e universitetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Renditja e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës në rankimet ndërkombëtare Universiteti "Aleksandër Moisiu" ka bërë përparime të dukshme në renditjet ndërkombëtare dhe kombëtare gjatë viteve të fundit. UAMD renditet si një nga universitetet më të mira në Shqipëri, zakonisht në vendin e tretë. Ky pozicion reflekton një reputacion të fortë dhe një angazhim për cilësinë akademike. Në renditjen për vitin 2025, UAMD ka marrë vendin e 137-të në Evropën Jugore. Rezultati tregon një rritje të vazhdueshme në përpjekjet për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit. Globalisht, UAMD renditet rreth vendit të 5375.


Renditja tregon se, megjithëse ka përparime, universiteti ende nuk është në nivelin më të lartë të universiteteve në botë, duke treguar nevojën për përmirësim në disa aspekte të rëndësishme si kërkimi shkencor dhe ndërkombëtarizimi. Për të arritur një renditje më të lartë në skenën ndërkombëtare, universiteti duhet të fokusohet në rritjen e investimeve në kërkimin shkencor, përmirësimin e ndërkombëtarizimit dhe përmirësimin e standardeve të mësimdhënies. Angazhimi në këto fusha do të ndihmojë në forcimin e pozicionit të tij në renditjet ndërkombëtare dhe do të kontribuojë në avancimin e arsimit të lartë në Shqipëri.

#### Ndërkombëtarizimi fakte dhe shifra

Strategjia Kombëtare për Arsimin në Shqipëri për periudhën 2021-2026 thekson ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë si një objektiv strategjik kyç. Qëllimi është të përmirësohet cilësia e arsimit dhe të krijojen mundësi më të mira për studentët shqiptarë në tregun global të punës. Bashkëpunimi me universitete të huaja është i domosdoshëm për të rritur mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik, si dhe për të promovuar shkëmbimin e njohurive dhe resurseve. Në këtë kuadër, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës ka luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e arsimit të lartë dhe ndërkombëtarizimin e tij.

UAMD, ka pasur si një nga objektivat kryesore, ndërkombëtarizimin e programeve të studimit. Ky objektiv ka qenë pjesë e Planit të Zhvillimit Strategjik 2020-2025 dhe Strategjisë së Ndërkombëtarizimit 2022-2024. Në këtë kontekst, universiteti ka përqafuar ndërkombëtarizimin si një mundësi për studentët, por edhe si një mënyrë për të integruar sistemin e tij arsimor në hapësirën evropiane dhe ndërkombëtare.

Objektivat Kryesore për Ndërkombëtarizimit kanë përfshirë:



## UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

- Rritjen e cilësisë dhe numrit të projekteve kërkimore në shkencë, teknologji dhe inovacion.
- Zhvillimin dhe forcimin e strukturave mbështetëse për ndërkombëtarizimin e institucionit.
- Promovimin e rrjeteve dhe anëtarësive në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Mesdheut dhe vendet anëtare të OSBE-së.


Një aspekt thelbësor i ndërkombëtarizimit të UAMD-së është krijimi i programeve të studimit me diplomë të dyfishtë në bashkëpunim me universitete të njohura në Evropë. Këto programe ofrojnë një mundësi unike për studentët që të marrin dy diploma nga institucione të ndryshme, duke rritur kështu përgatitjen e tyre për tregun global të punës. Disa nga këto programe përfshijnë:

- Doktoratë në Të Drejtë Publike, në bashkëpunim me Universitetin Tor Vergata, Romë, Itali.
- Master në Administrim Publik, në bashkëpunim me Universitetin Cote d'Azur, Nicë, Francë.
- Master në Ligjin Evropian dhe Krahasues, në bashkëpunim me Universitetin La Sapienza, Romë, Itali
- Bachelor në Shkencat Ndërkombëtare dhe Diplomatike, në bashkëpunim me Universitetin e Genovas, Itali.
- Doktoratë në Shkencat e Edukimit, në bashkëpunim me Universitetin Pedagogjik të Krakovit, Poloni.
- Bachelor në Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, në bashkëpunim me Universitetin La Sapienza, Romë, Itali.
- Doktoratë në Pedagogji, në bashkëpunim me Universitetin "The Philosopher", Nitra, Slloveni.
- Master në Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Mjedisit Detar në bashkëpunim me Universitetin e Malit të Zi dhe Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Këto partneritete përfaqësojnë një hap përpara në rritjen e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe ofrimin e një formimi akademik të cilësisë së lartë.

Një tjeter prioritet strategjik i UAMD-së është zhvillimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit, përmes projekteve ndërkombëtare dhe nismave për transferimin e njohurive. Universiteti ka realizuar një numër të madh projektesh, duke përfshirë:

- 21 projekte Erasmus+ CBHE, ku UAMD ka qenë lider në tre prej tyre.
- 4 projekte Interreg, si MISTRAL, HELIX, HISTEK dhe CRESCENDO.



## UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS

- **31** projekte të finançuara nga UAMD për të mbështetur stafin akademik dhe studentët.
- **8** projekte të finançuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSH).
- **4** projekte për ndërkombëtarizimin
- **1** Jean Monnet

Këto projekte ndihmojnë në përparimin e shkencës dhe teknologjisë, por gjithashtu përforcojnë pozicionin e UAMD-së si një lider në kërkimin shkencor në rajon.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” ka vendosur një rrjet të gjerë marrëveshjesh shkëmbimi me 94 institucione të arsimit të lartë në më shumë se 20 vende. Këto marrëveshje përfaqësojnë një angazhim të fortë për ndërkombëtarizimin e arsimit dhe ofrojnë mundësi për studentët dhe stafin të angazhohen në aktivitete akademike dhe kulturore jashtë vendit.


Në aspektin e mobilitetit akademik, ne kemi arritur një numër të lartë të mobiliteteve të stafit me kohë të plotë, duke shënuar 164, si dhe 187 pjesëmarrje në projekte mobiliteti. Këto mobilitete janë thelbësore për zhvillimin profesional të stafit dhe ofrojnë mundësi për të sjellë njoħuri dhe praktika të reja në universitetin tonë. Mobiliteti rrit përvojën e stafit, por kontribuon edhe në krijimin e një kulture akademike më të hapur dhe bashkëpunuese.

Ndërkohë, UAMD ka ndjekur një vizion për të forcuar kapacitetet kërkimore, duke përfituar nga mundësitë e projekteve ndërkombëtare dhe duke krijuar një rrjet bashkëpunimi të gjerë me universitete dhe organizata në rajon dhe më gjerë.

### Kërkimi shkencor

Roli i universiteteve si qendra të dijes dhe inovacionit është më i rëndësishëm se kurrë. Universiteti ynë ka bërë përparime të dukshme në disa aspekte thelbësore të zhvillimit akademik dhe kërkimor, duke e vendosur veten në një pozicion të favorshëm për të përballuar sfidat dhe për të shfrytëzuar mundësitë që ofron konteksti dinamik.

Një nga treguesit më të rëndësishëm të suksesit tonë është numri i **226** publikimeve të indeksuara në Scopus. Këto publikime pasqyrojnë angazhimin tonë për kërkimin shkencor dhe dëshmojnë për cilësinë e lartë të punës sonë. Publikimi në revista ndërkombëtare është thelbësor, përritjen e reputacionit tonë global dhe për përhapjen e dijes që ne krijojmë. Megjithatë, nuk duhet të harrojmë se 99 publikime në revista kombëtare, gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në avancimin e kërkimeve dhe njoħurive në kontekstin lokal.



Një tjetër aspekt kyç është pjesëmarrja në konferenca, me mbi 1040 pjesëmarrje të regjistruara nga stafi dhe studentët tanë. Këto aktivitete ofrojnë mundësi të shumta për shkëmbimin e ideve, përmirësimin e njohurive dhe krijimin e lidhjeve të reja me kolegë nga e gjithë bota. Ato janë të domosdoshme për ndarjen e rezultateve të kërkimit dhe për forcimin e pozicionit tonë në arenën akademike ndërkombëtare. Rrjetëzimi që ndodh në këto konferenca është një mundësi për të hapur dyer të reja për bashkëpunim dhe inovacion.


Sidoqoftë, përballë këtyre arritjeve, është e rëndësishme të identifikojmë edhe sfidat që na presin. Rritja e numrit të publikimeve dhe angazhimi në konferenca është e nevojshme për të ruajtur dhe përmirësuar reputacionin tonë, por kërkon gjithashtu mbështetje dhe strategji të qarta. Ne duhet të investojmë në zhvillimin e mëtejshëm të stafit dhe të ofrojmë mundësi për trajnime dhe avancime profesionale, për të siguruar që ata të janë në gjendje të kontribuojnë në nivele më të larta dhe të angazhohen në projekte kërkimore më ambicioze.

## Studentët

Universiteti “Aleksandër Moisiu” ofron një mjeshtëri pasur për angazhimin dhe zhvillimin e studentëve përmes një game të gjerë aktivitetesh dhe klubeve studentore. Këto iniciativa janë të dizajnuara për të nxitur bashkëpunimin, kreativitetin dhe zhvillimin e aftësive lideruese, duke i dhënë mundësi studentëve të angazhohen më thollë në jetën akademike dhe shoqërore.

Në UAMD, aktivitetet studentore përfshijnë një sërë klubesh, secili me fokus të veçantë:

1. Klubi i Librit
2. Klubi i Juristëve të Rinj
3. Klubi ICT
4. Klubi i Shahut
5. Klubi Start-Up
6. Klubi i Matematikës
7. Klubi i Diplomatëve
8. Klubi i Debatit



## UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS

9. Klubi i Multimedia dhe Fotografisë
10. Klubet sportive

Kampi kryesor i UAMD ndodhet pranë detit, në një zonë që ofron lehtësi për qasjen në qytet dhe një ambient frysues për studentët dhe stafin. Kjo ndërtesë përfshin Rektoratin, zyrat administrative dhe dy nga fakultetet. Përveç kësaj, kampusi tjetër ndodhet jashtë qytetit, me dy ndërtesa kryesore, në të cilat ndodhen tre fakultete të tjera. Këtu, një tjetër godinë është në ndërtim e sipër, duke e zgjeruar kështu infrastrukturën e Universitetit për të përbushur nevojat e një komuniteti studentor në rritje. Universiteti ka rrreth 17,000 studentë dhe puneson mbi 500 anëtarë të personelit akademik, i cili është përkushtuar për t'i shërbyer me profesionalizëm dhe inovacion këtij komuniteti dinamik.

### Fakultetet

Struktura akademike e UAMD-së përfshin pesë fakultete kryesore: Fakulteti i Edukimit, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Studimeve Profesionale dhe Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike. Çdo fakultet është i pajisur me mqedise të specializuara për mësim dhe kërkim, duke siguruar që studentët të përgatiten jo vetëm në aspektin teorik, por edhe praktik.

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ka laboratorë të avancuar, përfshirë laboratorët e kompjuterëve, elektronikës, një studio audio-video dhe një qendër për realitetin virtual. Këto ambiente moderne i lejojnë studentëve të përvetësojnë aftësi praktike që do t'i ndihmojnë ata të gjejnë punësim në fusha si zhvillimi i softuerit, shkenca e të dhënavës dhe teknologjitet e reja.

Fakulteti i Edukimit ofron mqedise të dizajnuara për mësimdhënie interaktive dhe të kombinuar, duke përfshirë salla mësimi moderne dhe të pajisura me teknologji për mësim. Ky fakultet ka një fokus të veçantë në përgatitjen e edukatorëve kompetentë, të cilët janë të gatshëm për të përballuar sfidat e sistemit arsimor modern.

Fakulteti i Studimeve Profesionale, i përqëndruar në trajnimet profesionale dhe teknike, ka laboratorë të specializuar, përfshirë laboratorët për inxhinierinë mekanike, detare, fizioterapinë, fizikën dhe eficencën e energjisë. Këta laboratorë sigurojnë një mësim të bazuar në praktikë, duke përgatitur studentët për sfidat konkrete të tregut të punës.

### Infrastrukturë e përbashkët dhe shërbime shtesë

Përveç faciliteteve të dedikuara për çdo fakultet, UAMD ofron infrastrukturë të përbashkët që mbështet jetën akademike dhe kulturore të komunitetit universitar. Kampusi përfshin



## UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS

tre sala konferencash, të cilat përdoren për konferanca shkencore, ligjërata të ftuara dhe aktivitete kulturore, duke krijuar një atmosferë që stimulon shkëmbimin intelektual. Bibliotekat janë një tjetër aset i rëndësishëm. Universiteti ka tre biblioteka të mëdha, të cilat ofrojnë një gamë të gjerë burimesh akademike, duke përfshirë libra, revista dhe materiale digitale. Me një koleksion prej rreth 60,000 titujsh në gjuhën shqipe dhe të huaj, bibliotekat ofrojnë mbështetje për studentët dhe stafin në kërkimet dhe studimet e tyre. Bibliotekat ofrojnë qasje në materiale në formate të ndryshme, përfshirë kopje fizike dhe elektronike, dhe gjithashtu ofrojnë një shërbim bibliotekar online që u mundëson studentëve të kenë qasje në libra dhe revista shkencore, nga kudo dhe në çdo kohë. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i infrastrukturës së UAMD-së është shërbimi i transportit dhe parkimit. Universiteti ofron shërbime autobusësh për të lehtësuar qasjen në kampus dhe për të përmirësuar përvojën e studentëve dhe stafit.

Aktualisht, UAMD nuk ofron akomodim për studentët. Megjithatë, Universiteti është i angazhuar për të përmirësuar përvojën studentore dhe ka plane konkrete për të ndërtuar ambiente akomodimi që do të ofrojnë strehim të përshtatshëm dhe të rehatshëm për studentët.


### Akreditimi institucional dhe i programeve

UAMD është plotësisht i akredituar dhe përmbush ligjin për arsim të lartë në Shqipëri. Akreditim garanton cilësinë e arsimit dhe mbështetjen për studentët e profesionistët e ardhshëm në fushën e tyre të studimit. Akreditimi është një tregues i angazhimit të universitetit për të ofruar një arsim të cilësisë së lartë dhe për të siguruar që studentët të jenë të përgatitur për të përballuar sfidat e tregut të punës.

## Analiza SWOT

Pikat e forta

Pikat e dobta



- |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Universiteti ka një numër të konsiderueshëm studentësh, duke krijuar një mjedis aktiv dhe bashkëpunues.</li> <li>2. Oferta akademike e diversifikuar në të tre ciklet e studimit me një gamë të gjerë programesh akademike në fusha të ndryshme.</li> <li>3. 8 diploma te dyfishta me universitete evropiane</li> <li>4. Kampus bashkëkohor për studentët dhe stafin akademik.</li> <li>5. Partneritete me universitete dhe institucione ndërkombëtare për shkëmbimin e përvojave dhe projekteve.</li> <li>6. Rritje e vazhdueshme e numrit të projekteve dhe mobiliteteve për stafin dhe studentët.</li> <li>7. Aleanca STARS EU.</li> <li>8. Pjesëmarrja si partner i asociuar në aleanca universitare.</li> <li>9. Staf akademik i kualifikuar të cilët kanë ndihmuar në rritjen e reputacionit të universitetit.</li> <li>10. Marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe biznese që forcojnë ofertën e universitetit.</li> </ol> | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Promovim më i mirë i brandit UAMD.</li> <li>2. Vizibiliteti i programeve të ciklit të tretë.</li> <li>3. Mungon kohezioni me komunitetin Alumni.</li> <li>4. Forcim i ndjenjës së përkatësisë ndaj UAMD-së.</li> <li>5. Mungesa e financimeve të mjaftueshme për kërkimin dhe zhvillimin e projekteve.</li> <li>6. Përmirësimi i Infrastrukturës me hapësira digitale .</li> <li>7. Shërbimi i transportit i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat e studentëve dhe stafit.</li> <li>8. Mungesa e konvikteve dhe mensave .</li> <li>9. Shkalla e pjesëmarrjes në kërkim shkencor.</li> <li>10. Ndikimi i renditjeve të ulëta në imazhin e universitetit.</li> <li>11. Vështirësitë në koordinimin e aktiviteteve dhe programeve midis departamenteve.</li> <li>12. Tërheqje e studentëve të huaj.</li> </ol> |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

Mundësítë	Kërcënimet
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mundësítë për të zgjeruar marrëdhënien ndërkombëtare dhe projekte të përbashkëta në kuadër të Aleancës STARS EU.</li> <li>2. Përdorimi i teknologjisë për të përmirësuar mësimdhënien dhe proceset akademike.</li> <li>3. Mundësítë për të sigruar financime nga fondet publike, organizata ndërkombëtare dhe projekte kërkimore.</li> <li>4. Rritja e rëndësisë së mësimdhënieve online, që mund të ofrojë fleksibilitet për studentët.</li> <li>5. Rritja e nevojës për ekspertizë në fusha të caktuara, siç janë teknologjia e informacionit, konsulenca, dhe menaxhimi.</li> <li>6. Rritja e pjesëmarrjes në konsorciume, organizata dhe aleanca universitare evropiane.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rritja e konkurencës nga universitete të tjera në Shqipëri dhe rajon.</li> <li>2. Ndryshimet në politikat e arsimit të lartë që mund të ndikojnë në funksionimin e universitetit.</li> <li>3. Ndikimi i krizave ekonomike dhe sociale.</li> <li>4. Ndikimi i financimit të arsimit të lartë dhe burimet për studentët.</li> <li>5. Rritja e migrimit të talenteve që mund të çojë në humbjen e burimeve të vlefshme për universitetin.</li> </ol>



7. Rritja e numrit te diplomave te përbashkëta dhe te dyfishta.

## Prioritetet strategjike


- 1. Mësimdhënia dhe studentët**
- 2. Kërkimi shkencor dhe inovacioni**
- 3. Ndërkombëtarizimi**
- 4. Infrastruktura dhe burimet njerëzore**



## 5. Komuniteti

## 6. Qeverisja dhe trasparenca

### Skema e Strategjisë



### Prioriteti 1: Mësimdhënia dhe studentët

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës synon të ofrojë një mjedis mësimor, i cili jo vetëm plotëson standartet më të larta akademike, por edhe fryshtëzon angazhimin aktiv të studentëve në procesin e të nxënës. Prioriteti "Mësimdhënia dhe studentët" thekson rëndësinë e një përvoje arsimore gjithëpërfshirëse, që zhvillon aftësitë praktike dhe intelektuale të studentëve, duke i përgatitur ata për sfidat e tregut të punës. UAMD synon të zbatojë praktika mësimdhënieje inovative, duke përfshirë teknologji bashkëkohore dhe metoda interaktive që nxisin pjesëmarrjen e studentëve, zhvillojnë mendimin kritik, kreativitetin, aftësitë analitike, duke i bërë ata të aftë të kontribuojnë në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit.



**Objektivi 1.1** Unifikimi i kurrikulave - Zgjerimi i ofertës akademike në gjuhë të huaja.

Rritja e numrit të programeve të studimit në gjuhë të huaja, krijimi i programeve të përbashkëta, diplomave të dyfishta ose të shumëfishta, për të ofruar një edukim ndërkombëtar për studentë vendas dhe të huaj.

**Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objekti:**

- Rritja e numrit të studentëve të huaj që ndjekin studime në UAMD, veçanërisht në programe të zhvilluara në gjuhë të huaja.
- Numri i programeve të përbashkëta, të dyfishta ose të shumëfishta me universitete partnere ndërkombëtare.
- Organizimi i shkëmbimeve studentore, praktikat ndërkombëtare dhe aktivitetet tjetra që përfshijnë partneritete ndërkombëtare.

**Objektivi 1.2:** Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimi i kompetencave të pedagogëve

**Ofrimi i trajnimeve dhe mundësive për zhvillimin profesional të vazdueshëm për stafin akademik, duke përfshirë përdorimin e metodave të mësimdhënies digjitale dhe teknologjive të avancuara.**

**Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objekti:**

- Numri i trajnimeve për pedagogët çdo vit akademik.
- Përqindja e metodave moderne të mësimdhënies të integruar në programe.
- Rezultatet e feedback-ut pozitiv nga studentët mbi cilësinë e mësimdhënies.

**Objektivi 1.3** Integrimi i teknologjisë në mësimdhënie mësim i kombinuar  
Mësimdhënie e bazuar në teknologji, duke krijuar fleksibilitet për studentët dhe duke përbushur kërkesat e tregut të punës.

**Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objekti:**

- Numri i kurseve online dhe hibride të ofruara çdo vit.
- Përdorimi i teknologjive të reja (simulime, aplikacione etj.) nga pedagogët.
- Rezultatet e kënaqësisë së studentëve për metodat digitale të mësimdhënies.

**Objektivi 1.4** Mikrokreditet, kurset afatshkurtra dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës  
Objektivi i ofrimit të mikrokrediteve, kurseve afatshkurtra dhe mundësive për mësim gjatë gjithë jetës synon të mbështesë zhvillimin profesional dhe personal të individëve, duke krijuar mundësi të aksesueshme për përmirësimin e aftësive dhe njohurive. Kurset



## UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS

afatshkurtra dhe trajnimet e orientuara drejt zhvillimit të aftësive specifike, ofrojnë mundësi për individët të përmirësojnë njohuritë dhe të rrisin konkurrueshmërinë në tregun e punës. Mësimi gjatë gjithë jetës, gjithashtu, mbështet krijimin e mundësive për individë të çdo moshe për të zhvilluar aftësitë e nevojshme duke ndihmuar në zhvillimin e një force pune të kualifikuar.

### ***Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objektivi:***

- Numri i mikrokrediteve të ofruara për student.
- Numri i kurseve afatshkurtra të ofruara (si kurse profesionale ose trajnime për aftësi të caktuara).
- Pjesëmarrja e studentëve dhe profesionistëve në këto kurse.
- Shkalla e kënaqësisë së pjesëmarrësve, e matur përmes anketave dhe vlerësimeve pas përfundimit të kurseve.
- Krijimi dhe implementimi i programave të mësimit gjatë gjithë jetës për individë të çdo moshe.
- Numri i individëve që regjistrohen dhe përfundojnë programe të mësimit gjatë gjithë jetës.

**Objktivi 1.5** Zhvillimi i aftësive të buta si bazë për suksesin personal dhe profesional Ofrimi i trajnimeve dhe aktiviteteve për zhvillimin e aftësive të buta (komunikimi, lidershipi, puna në grup, mendimi kritik) në të gjitha ciklet e studimit.

### ***Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objektivi:***

- Numri i moduleve dhe aktiviteteve për aftësitë e buta në programe studimi.
- Përqindja e studentëve pjesëmarrës.

**Objktivi 1.6** Zhvillimi i një mjedisi mësimor gjithëpërfshirës e mbështetës Sigurimi i mundësive të barabarta për studentët dhe krijimi i një mjedisi që nxit diversitetin dhe përfshirjen sociale.

### ***Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objektivi:***

- Numri i aktiviteteve për promovimin e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes.
- Mbështetja për studentët me nevoja të veçanta (akses në infrastrukturë, teknologji ndihmëse).
- Numri i klubeve dhe aktiviteteve të organizuara çdo vit.
- Kënaqësia e studentëve mbi aktivitetet jashtëshkollore dhe ndikimin e tyre.

**Objktivi 1.7** Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore shkencore me financim nga UAMD



Krijimi i mundësive për studentët që të angazhohen në projekte kërkimore dhe shkencore, si dhe të marrin pjesë në aktivitete ndërkombëtare për zhvillimin e tyre profesional dhe akademik. Organizimi i aktivitetave sociale dhe kurrikulare që nxisin zhvillimin personal dhe komunitar.

**Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objektivi:**

- Numri i studentëve që marrin pjesë në projekte kërkimore çdo vit.
- Shkalla e përfshirjes në aktivitete ndërkombëtare si konferenca dhe shkëmbime studentore.

**Objktivi 1.8 : Punësimi i studentëve ekselentë dhe rritja e bashkëpunimit me alumni**  
Zhvillimi i rrjeteve të forta me alumni për të ofruar mundësi zhvillimi për studentët.

**Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objektivi:**

- Numri i studentëve ekselentë të punësuar.
- Numri i alumni të përfshirë në mentorim dhe aktivitete universitare.
- Numri i marrëveshjeve ndërkombëtare aktive që përfshijnë studentët.

## Prioriteti 2: Kërkimi shkencor dhe Inovacioni

Në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, kërkimi shkencor është një prioritetet kryesor strategjik. Kjo strategji ka për qëllim fuqizimin e kërkimit shkencor në UAMD, me qëllim rritjen e rolit dhe kontributit ë tij në këtë fushë. Kërkimi shkencor duhet të synojë që me produktin që ai krijon të ketë impakt real në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, teknologjik dhe social kombëtar dhe rajonal. Kërkimi shkencor dhe infrastruktura e ngritur për këtë qëllim duhet të krijojë kushtet dhe terrenin e duhur për zhvillimin e inovacionit. Strategjia, gjithashtu do të ndihmojë në rritjen e kontributit shkencor dhe akademik në funksion të përmirësimit të pozicioni i UAMD-së në arenën ndërkombëtare. Në këtë kuadër, hapja e tij drejt bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe krijimi i një network-u të qëndrueshëm, do të shtronë rrugën drejt një progresi të qëndrueshëm e cilësor në të ardhmen. Duke e parë kërkimin shkencor në këtë fokus, lind nevoja e përqëndrimit në disa objektiva konkretë për realizimin e të cilave kërkohet të punohet ne vitet në vazhdim.

### Objktivi 2.1 Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor



Kërkimi shkencor në UAMD duhet të fokusohet në standartet e cilësisë, të cilat duhet t'i referohen sistemeve ndërkombëtare të matjes së cilësisë dhe impaktit të kërkimit shkencor. Në ndjekje të këtij prioriteti, UAMD duhet të inkurajojë dhe të mbështesë impakti, rritjen e publikimeve shkencore në revista ndërkombëtare me faktor shkencor. UAMD duhet të mbështesë organizimin e eventeve shkencore ndërkombëtare, që do të ndihmonin në krijimin e një network-u të domosdoshëm me rrjetet e kërkuesve institucionale krahas institacioneve homologe ne Evropë e më gjerë.

Një element tjeter i rëndësishëm, në funksion të rritjes së cilësisë së kërkimit shkencor në UAMD është dhe nevoja për rritjen e kapaciteteve dhe aftësive të kërkuesve. UAMD duhet të punojë në përmirësimin e aftësive dhe njojurive të reja në fushat e kërkimit, në të përparuara të kërkimit shkencor. Kjo do të materializohet në programe të trajnimit të vazhdueshëm të stafeve dhe studentëve me dijet më të avancuara shkencore, duke nxitur dhe mbështetur kërkuesit për avancimet e tyre në karrierën akademike.

Një kërkim shkencor cilësor duhet të mbështetet nga një infrastrukturë kërkimore e avancuar. UAMD, duhet të investojë në ngritjen e laboratorëve modern, pajisjeve të nevojshme dhe burimeve teknologjike të nevojshme për një kërkim serioz me impakt të lartë. Prioritet duhet të jetë përvetësimi i aftësive dhe të njojurive të reja, transferimi i tyre për përfitimin e përgjithshëm publik, me synim rritjen e nivelit të mirëqenies sociale, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit. Ngritja dhe fuqizimi i Qendrave Kërkimore moderne, duke investuar në infrastrukturën e nevojshme të avancuar teknologjike, për të mbështetur kërkimet shkencore me impakt të lartë kombëtar dhe ndërkombëtar.

#### Indikatorët për monitorimin dhe ralizimin e këtij objektivi:

- Krijimi i komisionit per promovimin e titujve akademik.
- Numri i publikimeve në revista shkencore me faktor impakti dhe revistave të indeksuara si Scopus, Thomson Reuters etj.
- Rritja e numrit të citimeve përmes një angazhimi më të madh me komunitetin shkencor brenda dhe jashtë vendit dhe përmes shpërndarjes efektive të punimeve.
- Përditësimi dhe menaxhimi efektiv i profileve individuale dhe institucionale në platformat e kërkimit shkencor me vizibilitet të lartë si Research Gate, Academicus etj.



## UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

- Trajnim i vazhdueshëm i kërkuesve shkencor me metodologjitetë më të reja të kërkimit dhe për aftësimin e tyre me teknologjitetë e reja në këtë fushë.
- Investimi në laboratorë modern, pajisje të teknologjisë së lartë dhe produkte digitale.
- Gjendja e bibliotekave fizike dhe mundësitë përtë aksesuar biblioteka digitale dhe aktiviteti i kryer në to.

Objktivi 2.2 Sigurimi i impaktit të kërkimit shkencor në jetën e vendit

Krahas cilësisë së kërkimit shkencor, komponenti tjeter i rëndësishëm është sigurimi i produkteve të kërkimit shkencor që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm kombëtar dhe rajonal. Përtë realizuar këtë prioritet kërkohet që të bëhen të gjitha përpjekjet përzgjerimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në lidhje me kërkimin.

Po aq i rëndësishëm do të jetë edhe bashkëpunimi me biznesin, institucione publike, të shoqërisë civile dhe palë të treta të interesuara për veprimtari shkencore dhe inovacion. Gjithashtu, përgjedha e fushave të kërkimit nga kërkuesit e rinj në programet e Doktoraturës, duhet të udhëhiqet nga lidhja që këto programe kanë me prioritete sociale, ekonomike dhe mjedisore të vendit.

Transformimi i UAMD-së në një qendër të rëndësishme kërkim-zhvillimi, si dhe rritja e mundësive përtë ofruar aktivitet kërkim-zhvillimi përtale të treta, do të krijonte mundësi të mëdha që kërkimi shkencor të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social, mjedisor dhe të kishte një impakt përtë gjithë shoqërinë.

Krijimi i një Parku Teknologjik në UAMD përtë nxitur dhe mbështetur krijimin dhe zhvillimin e Startup-ve, do të tërhiqte vëmendjen dhe interesin e bizneseve të industrive të ndryshme, agjencive qeveritare dhe aktorëve të tjera përtë financuar e mbështetur idetë e reja përbiznes.

### Indikatorët përmirësimi dhe realizimin e këtij objktivi:

- Bashkëpunimi me biznesin, qeverisjen qëndrore dhe lokale në projekte të përbashkëta kërkim-zhvillimi
- Përputhja e tematikave të kërkimit shkencor me prioritetet kombëtare të zhvillimit të vendit.
- Përfshirja në kërkimin shkencor e prioriteteve të zhvillimit rajonal.
- Realizimi i projektit të ndërtimit të Parkut Teknologjik me të gjitha kapacitetet e nevojshme.
- Financimet e përfituar nga biznese apo grupe të tjera interesit në funksion të kërkimit shkencor përllogari të palëve të treta.



## UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS

- Organizimimi i konkurseve dhe eveneteve që ftojnë studentët, profesionistët e rinj apo kërkuesit të shpalosin idetë e tyre për Startup-e. Gjithashtu numri i Startup-ve të krijuara dhe zhvilluara më pas në ide biznesi do të ishte një indicator domethënës për këtë objektiv.

### Objktivi 2.3 Fuqizimi i lidhjeve ndërkombëtare të UAMD

Fuqizimi i lidhjeve dhe prezencës ndërkombëtare të UAMD-së përmes pjesmarrjes institucionale në rrjete dhe aleanca ndërkombëtare të institacioneve homologe, do të ndihmonte thellësisht në rritjen e nivelit të kërkimit shkencor, shpërfaqjes institucionale në funksion të një imazhi më pozitiv në arenën ndërkombëtare. Fuqizimi i lidhjeve ndërkombëtare e sidomos me kapacitetet e diasporës shqiptare në botë, do të ndihmonte kërkuesit shkencor në krijimin e një sinergjie përmes shkëmbimit të ideve dhe promovimit të lëvizshmërisë. Pjesëmarrja në projekte të përbashkëta me prezencë të diasporës, do të rriste shanson përsukses të këtyre projekteve.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” duhet të punojë fuqishëm për pjesëmarrjen aktive në programet evropiane të kërkimit shkencor, si Horizon Europe dhe Erasmus+ etj., duke shtuar numrin e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta kërkimore. Rritja e bashkëpunimit me institucione kërkimore ndërkombëtare për projekte të përbashkëta në fushën e teknologjisë, inovacionit dhe shkencës duhet të shoqërohet me rritjen e kapaciteteve humane për të rritur shanson e përthithjes së fondeve të Bashkimit Evropian, si dhe programeve kombëtare për shkencën, përmes projekteve fituese.

Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet homologe në Evropë do ti jepte një shtysë mobilitetit të stafeve akademike dhe shkëmbimit të studentëve, në mënyrë reciproke duke mundësuar hapjen drejt mundësive dhe ideve të reja.

Në fokus së strategjisë së UAMD-së për kërkimin shkencor duhet të jetë përmirësimi i pozicionit të institucionit në rankimet ndërkombëtare, në funksion të përmirësimit të reputacionit institucional në rang ndërkombëtar. Fokusi i punës për përmirësimin e pozicionit të universitetit ne arenën ndërkombëtare do të jetë plotësimi i kriterieve specifike që agjensitë e rankimit ndërkombëtar përdorin.

### Indikatorët për monitorimin dhe ralizimin e këtij objktivi:

- Organizimi i eveneteve dhe aktiviteteve shkencore të përbashkëta me institucione të tjera homologe.
- Pjesëmarrja e bashkëatdhetarëve nga diasporës në projekte të përbashkëta, në punë shkencore të përbashkët me kërkuesit tanë shkencorë.



## UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

- Numri i aplikimeve në programe ndërkombëtare dedikuar kërkimit shkencor dhe numri i projekteve të fituara në këto programe.
- Marrëveshjet e lidhura me universitete të huaja dhe intensiteti i aktiviteteve të përbashkëta që burojnë nga këto bashkëpunime.
- Aktivitetet e ndërmarrë për përbushjen e kritereve që marrin parasysh agjencitë ndërkombëtare të rankimeve .

Objktivi 2.4 Ngritura e një sistemi të saktë e të qëndrueshëm të vlerësimit të performances së Kërkimit Shkencor

Ngritura e një sistemi të qëndrueshëm, me një metrikë të saktë, i referohet përcaktimit të treguesve të matjes së punës në kërkimin shkencor, duke ju referuar sistemeve më të mira ndërkombëtare të matjes së performancës së kërkimit shkencor. Kjo metodologji do të ndihmonte në matjen e cilësisë dhe vlerësimin e performancës individuale së kërkuesve, si dhe të performancës institucionale. Ngritura e një sistemi periodik vlerësimi do të jepte gjithashtu, një panoramë të qartë të mangësive, vështirësive dhe faktorëve penges, duke ndihmuar në një analizë që do të synonte progresin e vazhdueshëm e të qëndrueshëm në kërkimin shkencor.

### Indikatorët për monitorimin dhe ralizimin e këtij objektivi:

- Publikimet në Revistat shkencore me faktor impakti.
- Prezenca me publikime në databazat e rëndësishme shkencore si Scopus, Web of Science, JSTOR dhe EBSCO.
- Numri i citimeve të publikimeve të kërkuesve shkencore.
- Numri i projekteve të fituara dhe matja e impaktit të tyre në prioritetet strategjike.
- Avancimi në marrjen e Gradave Shkencore dhe Titujve Akademikë.

## Prioriteti 3: Ndërkombëtarizimi

UAMD ka vendosur ndërkombëtarizimin si një nga prioritetet strategjike kryesore, duke u përkushtuar për të ndërtuar një institucion të hapur dhe të integruar në arenën ndërkombëtare të arsimit të lartë. Ky prioritet ka qenë pjesë thelbësore e Planit të Zhvillimit Strategjik 2020-2024, Strategjisë së Ndërkombëtarizimit 2022-2024, si dhe është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit në Shqipëri 2021-2026, e cila



## UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

synon të rrisë konkurrueshmérinë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të sistemit arsimor kombëtar.

Në këtë kontekst, UAMD synon të luaj një rol të rëndësishëm si një universitet publik dhe gjithëpërfshirës, duke përforcuar profilin e një qendre kërkimore multidisiplinare, me fokus në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Në përpjekjet e tij për të arritur një ndërkombëtarizim të suksesshëm, Universiteti përballet me disa objektiva të rëndësishme në kuadër të ndërkombëtarizimit. Një prej objektivave kryesorë është nevoja për të përshtatur shërbimet administrative me standardet ndërkombëtare. Kjo është thelbësore për të siguruar një përvojë të kënaqshme për studentët ndërkombëtarë dhe për të përmbushur pritshmëritë e universiteteve partnere. Një tjetër objektiv që UAMD synon të realizojë është rritja e numrit të studentëve ndërkombëtarë. Për të arritur këtë qëllim, Universiteti synon përmirësimin dhe zgjerimin e programeve të përbashkëta që ofrojnë diploma të dyfishta ose të shumëfishta me universitete partnere në nivel ndërkombëtar. Këto programe janë të rëndësishme për të ofruar një përvojë të pasur akademike dhe për të rritur cilësinë e arsimit në UAMD. Kjo strategji do të ndihmojë në rritjen e diversitetit në kampus dhe në forcimin e reputacionit të universitetit, si një destinacion i preferuar për studentët e huaj. Për të realizuar këto objektiva, UAMD ka burime të rëndësishme në dispozicion. Një nga asetat kryesore është reputacioni ndërkombëtar. Si anëtar i aleancës STARS EU, UAMD ka ndërtuar një imazh të fortë tek institucionet partnere, gjë që ndihmon në tërheqjen e studentëve të huaj. Kjo anëtarësi ofron gjithashtu mundësi për bashkëpunime dhe projekte të përbashkëta që forcojnë lidhjet me universitete të tjera në Evropë dhe përtej. Kapacitetet e stafit akademik dhe administrativ janë një tjetër faktor thelbësor për suksesin e ndërkombëtarizimit. Stafi është i trajnuar dhe i përgatitur për të mbështetur proceset e ndërkombëtarizimit, duke rritur ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Ky angazhim për përmirësim të vazhdueshëm është i domosdoshëm për të siguruar që UAMD të ofrojë shërbime cilësore dhe në përputhje me kërkesat e studentëve dhe institucioneve partnere.

Për më tepër, Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, si edhe strukturat mbështetëse luajnë një rol kyç në koordinimin e iniciativave ndërkombëtare dhe sigurimin e suksesit të projekteve kërkimore. Këto struktura ndihmojnë në identifikimin e mundësive të reja për bashkëpunim dhe në organizimin e aktivitetave që promovojnë ndërkombëtarizimin e universitetit.

Objktivi 3.1 Promovimi i prioritetit të ndërkombëtarizimit në të gjitha aktivitetet e Universitetit



Ky objektiv ka për qëllim integrimin e ndërkombëtarizimit në çdo aspekt të funksionimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", duke përfshirë mësimdhënien, kërkimin shkencor, shërbimet administrative dhe aktivitetet studentore. Promovimi i ndërkombëtarizimit rritur bashkëpunimin ndërkombëtar, të përmirësojë cilësinë e arsimit dhe të kontribuojë në zhvillimin global të dijes. Kjo do të mundësojë që UAMD të përforcojë reputacionin e tij në arenën ndërkombëtare, të tërheqë më shumë studentë dhe staf ndërkombëtar, gjithashtu të marrë pjesë në projekte ndërkombëtare të nivelit të lartë.

***Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objektivi:***

- Përfshirja në rrjete ndërkombëtare akademike për kërkime dhe projekte të përbashkëta.
- Krijimi ose përmirësimi i shërbimeve administrative dhe infrastrukturës për të përbashkëta nevojat e studentëve dhe stafit ndërkombëtar, përfshirë mbështetjen gjuhësore dhe kulturore.
- Numri i projekteve kërkimore të finançuara ndërkombëtarisht, pjesëmarrja e stafit akademik në projekte të finançuara nga BE-ja dhe organizata të tjera ndërkombëtare.
- Numri i pedagogëve dhe studentëve të UAMD-së që marrin pjesë në programe shkëmbimi akademik, si Erasmus+ dhe programe të tjera të mobilitetit ndërkombëtar.

**Objktivi 3.2 Rritja e kapaciteteve të stafeve akademike**

Rritja e kapaciteteve të stafit akademik synon përmirësimin e aftësive dhe njohurive të profesorëve dhe lektorëve për të përballuar sfidat e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Objktivi përfshin zhvillimin profesional të stafit në mënyrë që ata të janë në gjendje të përdorin praktikat më të mira ndërkombëtare, të kontribuojnë në projekte kërkimore me vlerë të lartë dhe të përmirësojnë cilësinë e programeve akademike të universitetit. Kjo është thelbësore për të rritur konkurrueshmërinë e Universitetit dhe për të përbashkët standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë.

***Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objektivi:***

- Numri i trajnimeve dhe zhvillimeve profesionale të fokusuara në përmirësimin e metodave të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.
- Vlerësimi i rritjes së përfshirjes së stafit në projekte kërkimore dhe partneritete ndërkombëtare.



- Numri i artikujve dhe punimeve shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare të indeksuara.
- Numri i personelit akademik që merr pjesë dhe prezanton në konferenca shkencore ndërkombëtare.
- Përmirësimi i kompetencave gjuhësore të stafit për të mbajtur leksione dhe prezantime në gjuhë të huaj, për të përballuar kërkesat e ndërkombëtarizimit.
- Numri i profesorëve të ftuar të njohur ndërkombëtarisht për të ndarë përvoja dhe njohuri në fushat akademike.
- Zhvillimi i programeve të mentorimit ku stafi më i kualifikuar ndihmon kolegët më të rinj për të përmirësuar praktikat e tyre të mësimdhënies dhe kërkimit.

#### Objktivi 3.3 Aleanca STARS EU

UAMD është pjesë e aleancës STARS EU. Bashkëpunimi ndër-institucional i aleancës filloi në nëntor 2019. Aleanca STARS EU synon të bëhet një model i Universitetit Evropian duke zbatuar një vizion afatgjatë që transformon bashkëpunimin institucional ndërmjet 9 institucioneve të arsimit të lartë partnerë, duke përdorur të gjitha burimet fizike dhe intelektuale dhe duke u mbështetur në inputin dhe përvojën e partnerëve. Një nga objektivat kryesore të ndërkombëtarizimit të UAMD-së është rritja përmes pjesëmarrjes aktive në aleancën STARS EU, duke promovuar mobilitetin ndërkombëtar tradicional dhe inovativ të studentëve dhe stafit akademik, si dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta akademike dhe kërkimore me universitetet partnerë.

#### *Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objktivi:*

- Rritja e mobilitetit të studentëve dhe stafit dhe projektimi i formave të reja më fleksibile të mobilitetit ndërkombëtar në kuadër të STARS EU.
- Numri i diplomave të përbashkëta.
- Numri i kurseve të përbashkëta.
- Numri i mikrokrediteve të ofruara.
- Numri i mobiliteteve të përziera/blended ose virtuale të realizuara.
- Numri i shkëmbimeve të personelit akademik dhe teknik-administrativ.
- Numri i pjesëmarrjeve në Staff Week.
- Numri i konferencave të përbashkëta.

#### Objktivi 3.4 Zgjerimi i ofertës akademike në gjuhë të huaja



Rritja e numrit të programeve të studimit në gjuhë të huaj, krijimi i programeve të përbashkëta që ofrojnë diploma të dyfishta ose të shumëfishta, dhe zgjerimi i kapacitetit për të ofruar një edukim ndërkombëtar për studentët vendas dhe të huaj.

***Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objektivi:***

- Rritja e numrit të studentëve të huaj që ndjekin studime në UAMD, veçanërisht në programe të zhvilluara në gjuhë të huaja.
- Numri i programeve të përbashkëta, të dyfishta ose të shumëfishta me universitete partnerë ndërkombëtare.
- Organizimi i shkëmbimeve studentore, praktikat ndërkombëtare dhe aktivitatetave të tjera që përfshijnë partneritete ndërkombëtare.

Objktivi 3.5 Rritja e numrit të projekteve kërkimore ndërkombëtare

***Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objektivi:***

- Rritja e cilësisë dhe numrit të projekteve kërkimore ndërkombëtare në shkencë, teknologji dhe inovacion.
- Rritja e numrit të projekteve kërkimore të finançuara nga programe ndërkombëtare si Horizon Europe, Erasmus+, IPA dhe organizata të tjera ndërkombëtare.
- Zgjerimi i bashkëpunimeve me universitete dhe institutë kërkimore ndërkombëtare për projekte të përbashkëta në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit.
- Rritja e numrit të aplikimeve të sukseshme nga UAMD për financime ndërkombëtare për projekte kërkimore në shkencë dhe teknologji.
- Numri i aktivitatetave të trajnimit për stafin akademik dhe kërkimor që synojnë rritjen e aftësive për të aplikuar dhe menaxhuar projekte ndërkombëtare.
- Numri i pjesëmarrjeve të UAMD-së në rrjete ndërkombëtare kërkimore dhe konsorciume për teknologji dhe inovacion, që synojnë avancimin e shkencës në nivel global.



Objektivi 3.6 Rritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i mëtejshëm i strukturave mbështetëse për ndërkombëtarizimin

**Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objektivi:**

- Fuqizimi i kapaciteteve administrative dhe akademike për të mbështetur ndërkombëtarizimin, përmes ngritjes dhe përmirësimit të strukturave mbështetëse si drejtoria e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë.
- Numri i kurseve të gjuhës angleze të organizuara për personelin teknik-administrativ.

#### Prioriteti 4: Infrastruktura dhe burimet njerëzore

Infrastruktura dhe burimet njerëzore janë një nga segmentet më të rëndësishme të planit strategjik, duke ndikuar në aspekte të ndryshme të efektivitetit dhe suksesit institucional. Infrastruktura efektive siguron akses gjithëpërfshirës për studentët, stafin akademik dhe stafin tjetër, duke ndihmuar të gjitha njësítë që funksionojnë brënda UAMD-së. Infrastruktura është në funksion të krijimit të kushteve sa më të mira për procesin mësimor, për kërkime shkencore, ndërkombëtarizimin dhe për bashkëpunim me komunitetin. Nga ana tjeter, burimet njerëzore janë jetike për zhvillimin e Universitetit duke ndikuar drejtëpërdrejtë në cilësinë e arsimit, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Së bashku, këta elementë rrisin efektivitetin institucional, promovojnë inovacionin dhe kontribuojnë në suksesin e UAMD-së në përmbushjen e objektivave të tij.

##### Objktivi 4.1 Rekrutimi dhe ruajtja e profilit të stafit

Rekrutimi i stafit akademik dhe stafit tjetër në UAMD do të bëhet sipas meritokracisë, duke siguruar që të gjithë të kenë mundësi të barabarta në rekrutim, zhvillim personal dhe përparim në karrierë. Qëllimi jonë strategjik për një universitet lider nga cilësia e kërkimit shkencor dhe arsimit, përfshinë zhvillimin e stafit dhe zëvendësimin e stafit në pension me të diplomuar të rinj dhe doktorantë ambiciozë të kualifikuar.

Ne synojmë të forcojmë angazhimet e mbështetjes për të gjitha grupet e stafit, duke përfshirë trajnime të rregullta dhe programe për zhvillim personal dhe profesional, duke i përgatitur ata për sfidat dhe ndryshimet në ambientin universitar. Kjo përfshin seminare, workshopë, kurse të specializuara në menaxhimin e projekteve, trajnime mbi teknologjitet, softuerët, mjetet më të fundit TIK, dhe platformave të ndyshme dixhitale.

## UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Ne synojmë të krijojmë një mjedis dinamik dhe mbështetës që rrit bashkëpunimin, nxit inovacionin dhe forcon lidhjet e komunitetit. Kjo qasje strategjike, jo vetëm që përmirëson efektivitetin organizativ, por gjithashtu pasuron përvojën e përgjithshme arsimore për studentët dhe stafin. Kjo përfshin hapsira të përbashkëta inovative, burime të përbashkëta teknologjike, projekte ndërdisiplinore si dhe gjithëpërfshirje në vendimmarje.

### ***Indikatorët për monitorimin dhe ralizimin e këtij objektivi:***

- Proces të vazhdueshëm të monitorimit të performancës përkundrejt objektivave të përcaktuara në vlerësimin vjetor të stafit.

Objektiv 4.2 Përmirësimi i infrastrukturës, shërbimeve dhe logistikës Infrastruktura, shërbimet dhe logistika janë një tjetër segment shumë i rëndësishëm i planit tonë strategjik, që ndihmon të gjitha njësítë që funksionojnë brenda UAMD-së. Në këtë periudhë të planit strategjik, ne synojmë modernizimin e hapsirave të mësimdhënies, sigurimin e laboratorëve specifikë për programet studimore të veçanta, sigurimin e teknologjive përkatëse për të gjitha programet dhe të tjera.

Krijimi i qendrës së Inovacionit dhe Teknologjisë do të jetë një pikë shumë e rëndësishme në këtë segment. Kjo qendër do të funksionojë si një inkubator për ide të reja, ku studentët dhe stafi akademik mund të punojnë së bashku për të zhvilluar zgjidhje teknologjike që adresojnë sfidat kombëtare dhe globale. Kjo qendër do të ofrojë burimet e nevojshme, përfshirë pajisje të avancuara, hapësira për punë laboratorike, dhe akses në rrjete ndërkombëtare të investitorëve dhe partnerëve strategjik.

Krijimi i qendrave kërkimore në fakultete, gjithashtu është një tjetër pikë e rëndësishme e strategjisë sonë. Këto qendra do të funksionojnë si hub-e për inovacion dhe kërkim intensiv, të pajisura me resurset dhe infrastrukturën e nevojshme për të mbështetur hulumtime të thella dhe të specializuara. Gjithashtu parashihen edhe rregullimet e kampuseve, përmirësimi i transportit, ndërtimi i konvikteve, mensave studentore, qendrave argëtuese, dhe shërbimeve të tjera në këtë sektor.

### ***Indikatorët për monitorimin dhe ralizimin e këtij objektivi:***

- Numri i laboratorëve dhe qendrave kërkimore.
- Kryerja e anketave të rregullta tek studentët, stafi akademik dhe stafi tjetër mbi infrastrukturën, shërbimet akademike dhe shërbimet mbështetëse.
- Kompletimi i infrastrukturës mësimore dhe infrastrukturës së jashtme në funksion të studentëve.



#### Objektiv 4.3 Transformimi Dixhital i UAMD-së

Transformimi dixhital është një element kyç për zhvillimin proaktiv të UAMD-së, si tanë ashtu edhe në të ardhmen. Ne synojmë të shfrytëzojmë mundësitet e ofruara nga dixhitalizimi në të gjitha fushat e tij, në mënyrë ambicioze, për të promovuar zhvillimin, konkurrencën ndërkombëtare, organizimin dhe administrimin me cilësi të lartë dhe efikase dhe për të rritur shtrirjen e kërkimit akademik. Dixhitalizimi përfshin disa ndryshime me ndikim të gjerë që janë të lidhura me inovacionet dixhitale dhe efektet e tyre tek individët, organizatat dhe shoqëria. Detyrat tona janë të thellojmë të kuptuarit e këtyre zhvillimeve, të hetojmë mundësitet dhe sfidat dhe të kontribuojmë në zgjidhje inovative.

Dixhitalizimi i shërbimeve është një objektiv thelbësor i strategjisë sonë. Përmes dixhitalizimit të shërbimeve në UAMD, ne synojmë të rrisim efikasitetin, gjithëpërfshirjen, aksesin dhe të përmirësojmë përvojën e përgjithshme akademike për studentët, pedagogët dhe stafin tjetër. Ne synojmë krijimin e një sistemi qendror të menaxhimit të mësimit dhe zgjerimin e gamës së burimeve elektronike në Bibliotekën Universitare. Trajtimi i hapur dhe i qëndrueshëm i të dhënavë kërkimore duke u mbështetur në zgjerimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dixhitale, mbetet një nga proritetet tona. Për të konsoliduar këto shërbime dhe për të ndihmuar në formësimin e dinamikës së dixhitalizimit në një mënyrë proaktive, ne do të vazhdojmë të zhvillojmë në mënyrë strategjike shërbimet tona, përmes rritjes së investimeve në infrastrukturat dixhitale më të fundit dhe stafit të qëndrueshëm.

Ndër të tjera, kjo iniciativë strategjike përfshin:

- Zhvillimin e platformave dixhitale për studentët që të kenë akses në burime dhe shërbime nga kudo dhe në çdo kohë. Kjo përfshin materialet e kursit, oraret, notat, eventet, bibliotekat dhe shërbime administrative.
- Zhvillimin e platformave dixhitale E-Learning dhe platformave të Mësimit të Personalizuar. Këto platforma u mundësojnë studentëve të ndërveprojnë me kurrikulën në mënyrë që të përputhet me nevojat e tyre, duke kursyer kohën, duke rritur motivimin, përmirësojnë rezultatet e të mësuarit duke kapërcyer mangësitë në të mësuar dhe në të kuptuar.
- Zhvillimi i platformave dixhitale për stafin akademik duke u mundësuar atyre të punojnë në mënyrë më efikase dhe fleksibël në menaxhimin e mësimeve. Kjo përfshin materialet e kursit, syllabuset, oraret, artikujt shkencorë, projektet, këndin e komunikimit me studentët si dhe ndjekjen e progresit të tyre.



## UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

- Integrimin e inteligjencës artificiale (AI) në kërkimin shkencor, mësimdhënie dhe mësimnxënie, administrim dhe logistikë. UAMD është i bindur se është i pozicionuar në mënyrë ideale për të përqafuar dinamikën e zhvillimeve të AI dhe aplikimeve të saj në përbushje të prioriteteve strategjike.
- Përdorimin e shërbime inovative në Cloud për kërkim shkencor, mësimdhënie dhe administrim në mënyrë efikase dhe të sigurt. Duke adoptuar shërbime inovative cloud, ne synojmë të rrisin aftësitë kërkimore, të përmirësojmë metodologjitet e mësimdhënies dhe të thjeshtojmë proceset administrative.

Gjithashtu, dixhitalizimi i protokollit dhe arkivës, dixhitalizimi i bibliotekës, platforma punësimi të përbashkëta me bizneset dhe institucionet lokale e kombëtare, platforma të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë, dixhitalizimi i sektorit të Alumnit, si dhe të platoftave mbështetëse të Startupe-ve studentore.

### *Indikatorët për monitorimin dhe ralizimin e këtyj objektivi:*

- Numri i platformave dixhitale të aplikuara në UAMID në shërbim të studentëve, stafit akademik dhe stafit tjeter.
- Kryerja e anketave të rregullta mbi dixhitalizimin e shërbimeve, duke u fokusuar në përdorshmërinë, aksesueshmërinë dhe kënaqshmërinë e përgjithshme tek stafi akademik dhe stafi tjeter.



## Prioriteti 5: Komuniteti dhe përgjegjësia sociale

Me një përvojë të re në fushën e arsimit të lartë dhe me sfida të shumta në zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe politik në vend, si dhe arritjet në fushën e arsimit në nivel rajonal dhe kombëtar, Universiteti "Aleksandër Moisiu", dëshiron një ridimensionim të punës së tij, në shumë fusha e në veçanti në raportet dhe marrëdhëniet e tij me komunitetin. Në këtë këndvështrim puna me komunitetin, e cila është mjaft e rëndësishme në zhvillim, është gjithashtu dhe një risi përvitet e ardhshme, kjo pasi, marrëdhëniet me komunitetin, deri më tanë janë parë vetëm në kuadër të arsimit parauniversitar dhe pak ose aspak, në arsimin e lartë, ku në tërësi studentët janë të pavarur nga kontrolli dhe ndihma në mësimdhënie, e familjeve të tyre.

Në këtë kuadër është me shumë interes qasja e re që Universiteti duhet të ketë me komunitetin e prindërve, atë të biznesit dhe të institucioneve qeveritare vendore dhe qendrore, të institucioneve të tjera lokale dhe rajonale, në tërësi edhe me komunitetin që rrrethon mjediset ku ndodhen ndërtesat universitare.

Përqafimi i pjesëmarrjes popullore nuk është thjesht një zgjedhje, por një domosdoshmëri për formimin e një bote të qëndrueshme, paqësore, të barabartë dhe të drejtë në shekullin XXI dhe me shumë mundësi me një rëndësi jetike për shoqërinë tonë. Duke u nisur nga kjo perspektivë, shihet me shumë interes që në takime, workshopë, apo fushata sensibilizimi të shpjegohet se cila është rëndësia e shkollimit, marrjes së dijeve dhe



## UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

aftësive në një shoqëri si e jona, e cila u trasformua dhe po shkon drejt transformimit akoma më të madh që prej ndryshimit të sistetmit.

### Objktivi 5.1. Raportet e Universiteti me komunitetin e qytetarëve

Universiteti ofron mundësi të mira për formimin fillestar, trajnim dhe punë të mirëfilltë shkencore në fusha që përfshijnë shëndetin, edukimin, trajnimin, punën dhe balancën midis kohës së punës dhe kohës së lirë, mirëqenien ekonomike, marrëdhënie sociale, trashëgiminë kulturore, mjedisin, kërkimin dhe inovacionin, etj. Duke qenë se kemi një debatohet me një nga aktorët më të rëndësishëm që është komuniteti i gjerë dhe ai i ngushtë, për të vjet mendime, dhe pse jo, edhe ide të rëndësishme që përmirësojnë punën tonë sot dhe në të ardhmen.

Komuniteti është një barometër real për mënyrën sesi e perceptojnë ata punën tonë, diplomat, profilet dhe programet që ofrojmë dhe si, të gjitha këto janë kthyer në një e mirë ekonomik dhe mundësitë e përmirësimit të jetës së qytetarëve, janë të varura në një masë të madhe nga shkollimi dhe aftësitë që marrin të rinxjtë, për të cilat financuesit kryesorë të studimeve të tyre, janë familja, shoqëria dhe padyshim shtetit.

#### *Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objektivi*

- Krijimi i mundësive të informimit përmes mediave, broshurave dhe formave të tjera informative, të mundësojmë ndërgjegjësimin për programet e studimit që ofrohen, përparësitë e tyre, mundësitë e punësimit, ofrimit të mbështetjes me bursa për familjet në nevojë, etj.
- Takime të përbashkëta mes shkollave të, mesme, komunitetit dhe Univeristetit në lidhje me këshillmin e karrierës, për t'i orientuar të rinxjtë në përputhje me aftësitë që zotërojnë në përcaktimin e programeve univeristare dhe jouniversitare që ata do të ndjekin.
- Targetimi i shtresave vunerabël, për paraqitjen e ofertës univeristare, në bashkëpunim me përfaqësuesit e njësive vendore, që do të conte jo vetëm në shkollimin e fëmijëve të tyre dhe në rritjen potenciale të mundësive për të përmirësuar jetën individuale të tij por edhe familjes.
- Bashkëpunimi i ngushtë me komunitetit me fokus të veçantë të rinxjtë me aftësi dhe nevoja ndryshe, duke bashkëpunuar me familjet dhe komunitetin ku jetojnë, për t'i nxjerrë ata nga një gjendje të pashpresë, duke i dhënë një mundësi për vetëmenaxhimin e jetës së tyre për mes një profesioni të përfthuar nga programet e studimit që ne ofrojmë.



## UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

- Bashkëpunimi i ngushtë me OJF që punojnë për fuqizimin e gruas, me qëllim tërheqjen e tyre gjithnjë e më shumë drejt programeve universitare dhe jo universitare, të cilat fuqizojnë pozitën e tyre në shoqëri dhe rrisin mundësitë e pavarësisë së jetës ekonomike e sociale, jo vetëm në mësuesi dhe shkenca sociale, por dhe në ato programe që shihen si më shumë mashkullore.
- Vëmendje të shtuar ndaj komuniteteve rurale, me qëllim të qartë për të mundësuar qëjeta e tyre ekonomike dhe shoqërore të mbështetet nga dijet dhe aftësitë e përditësuara të përfshira prej fëmijëve të tyre në Universitetin tonë.

### Objktivi 5.2 Bashkëpunimi mes Univeristetit dhe komunitetit të biznesit

Me shumë interes shihet marrëdhënia me komunitetin e biznesit për të fuqizuar lidhjen mes studimit, reformimit të kurrikulave dhe programeve të studimit, në një qasje reale që ofron tregu i punës në qarkun e Durrësit por edhe në nivel kombëtar, rajonal e më gjerë. Zhvillimi i qëndrueshëm është për të përmbushur nevojat e së tashmes për njerëzit, mjedisin, shoqërinë dhe nevojat ekonomike pa kompromentuar aftësinë e brezave të zhvillimi i qëndrueshëm është një nga sfidat më të mëdha, subjekt i shumë debateve midis politikanëve dhe udhëheqësve të biznesit.

Konkretisht në vitet e fundit për arsyet e kuptueshme kombëtare dhe globale ka një lëvizje të popullatës, brenda vendit dhe jashtë tij. Në këtë lëvizje janë përfshirë përfatësia keq, burime të rëndësishme njerëzore, në fusha të ndryshme të ekonomisë, si në: Sektorin e shëndetsisë, teknologjisë së informacionit, turizmit, bujqësisë etj. Ndërkaq tregu vendas ndien mungesën e këtyre burimeve njerëzore, që po pakësohen dhe ende nuk nevojat janë shumë të ngutshme. Në këtë këndvështrim marrëdhëni me biznesin në nivel qarku dhe atë kombëtar, rajonal e më gjerë, marrin një rëndësi të dorës së parë, me përfitime të dyanshme për universitetin dhe biznesin. Mundësia për një qasje të re me biznesin, do t'i japë mundësinë këtij të fundit të shoh realisht, të diskutoj dhe të jap mendimin e tij mbi kurrikulat, programet, mënyrën e formimit fillosatr, trajnimin e studentëve, programet e praktikave etj. Përfatësia mirë Universitetit ynë ka një përvojë të konsoliduar me programet profesionale, e cila duhet zgjeruar edhe më tej, përditësuar me një plan masash të detajuar, përbashkëpunimin me sektorin e biznesit privat por edhe me autoritete të rëndësishme të jetës ekonomike, në Durrës si: Autoriteti Portual, Qendrat e Trashëgimisë Kulturore, institucionet financiare, Dhoma e tregëtisë dhe industrisë, etj.

## UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Me shumë interes, në marrëdhëniet me komunitetin e biznesit dhe me të gjithë aktorët e përmendur më sipër është fusha e inovacionit, ku dhënia jetë e projekteve të përbashkëta do t'i hapi rrugë fuqizimit të partneritetit mes palëve. Siguria kibernetike, navigacioni, inteligjenca artificiale në fushën e mekanikës dhe lundrimit janë po kaq tërheqëse si mundësi bashkëpunimi me përfitime të mëdha jo vetëm dypalëshe, por edhe në shërbim të studentëve, komunitetit dhe ekonomisë e mirëgenies sociale.

***Indikatorët përmatjen e arritjes së këtij objektivi.***

- Rishikimi dhe nëshkrimi i marrëveshjeve të reja me bizneset, në kosultim të plotë me ta me qëllimin jo thjesht përti pasur si nisma, por përtë shërbyer realisht në të mirë të dy palëve.
- Ngritja e Bordit të Tregut të Punës, me pjesëmarrës nga biznese të ndryshme, ish-studentë të UAMD, që janë një histori suksesi në tregun vendas dhe atë të huaj, pjesëtarë të universitetit dhe pushtetit lokal. Ky bord do të shërbejë përritjen e mundësive të punësimit të studentëve të UAMD-së, por edhe fuqizimit të bashkëpunimit mes aktorëve që përbëjnë këtë Bord.
- Rritja e gamës së praktikave profesionale në biznese të ndryshme, institucione financiare në ato të qeverisjes vendore etj, me qëllim vjeljen e përvojave më të mira por edhe qëmtimin real të burimeve njerëzore, të vlefshme përkëto insitucionë.
- Analiza periodike e arritjeve dhe problematikave të bashkëpunimit me bizneset, në mbledhje të përbashkëta mes Senatit Akademik, Asambleve të Fakulteteve dhe Bordit të Tregut të Punës.
- Nisma për veprimtari kërkimore shkencore të përbashkëta (studime të tregut të punës, studime në fushën sociale) mes universitetit dhe biznesit.
- Duhet të punohet përtë mobilizuar investime të përbashkëta në projekte infrastrukturore dhe në zbatimin e teknologjive të energjisë të rionvueshme si panelet diellore. Këto projekte do të ndihmojnë jo vetëm në përmirësimin e efikasitetit të energjisë në kampus, por edhe do të shërbejnë si modele për praktikat e qëndrueshme mjedisore.
- Bashkëpunimi mes bizneseve dhe universitetit në fusha shumë konkrete, siç mund të jenë, programe të përbashkëta (programe kros) mes fakulteteve dhe bizneseve apo institucioneve konkrete në fusha ku ato kanë nevojë.
- Fuqizmi i Qendrës së Karrierës, me qëllim qëmtimin e bizneseve, orientimin e studentëve drejt biznesve të sukseshme, bashkëpunimi i ngushtë me bizneset në lidhje me praktikat, kërkimin shkencor, inovacionin etj.

## UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

- Krijimi i një data baze me studentët e **diplomuar** dhe punësimin e tyre si dhe analizimi i lëvizjeve dhe rritjeve në karrierë të studentëve, duke synuar ndërmjetësimin për punësimin e studentëve dhe ndihmën për gjetjen e një vendi pune që u përshtatet dëshirave, formimit, aftësive dhe cilësive të tyre.
- Zgjerimi i listës së shërbimeve të favorizuara për studentë mbi bazën e kartës studentore. Identifikimi i shërbimeve të reja të ofruara nga institucionet publike ashtu dhe nga subjektet private nga të cilat studentët mund të përfitojnë ulje dhe oferta të dedikuara për ata.

### Objktivi 5.3 Rritja e Ndkimit Social dhe Ekonomik të UAMD-së

Rritja e ndikimit social dhe ekonomik të një universiteti është e rëndësishme për disa arsyet thelbësore, që prekin jo vetëm studentët dhe stafin e tij, por edhe komunitetin e gjerë dhe ekonominë e vendit. Rritja e ndikimit social dhe ekonomik të një universiteti është e domosdoshme për të siguruar që ai të mbetet një institucion kyç dhe i qëndrueshëm në një shoqëri në zhvillim të shpejtë. Ai jo vetëm që kontribuon në edukimin social të komuniteteve ku vepron. Universiteti nuk është thjesht një vend që prodhon dije, por edhe ndihmon në përhapjen e saj në komunitet. Rritja e ndikimit social të një universiteti mund të përmirësojë cilësinë e jetës së individëve në zonën përreth përmes projekteve që lidhen me shëndetin, edukimin, dhe shërbimet sociale. Një universitet që ka ndikim të madh social dhe ekonomik, ka më shumë mundësi të krijojë partneritete të forta me qeverinë, industrinë dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Këto partneritete krijojnë mundësi të reja për financime, projekte të përbashkëta, dhe rritje të mëtejshme të ndikimit të institucionit. Një universitet me një ndikim të fortë social dhe ekonomik tërheq studentë dhe staf akademik nga e gjithë bota. Kjo rrit reputacionin e tij si një institucion me ndikim pozitiv dhe si një qendër që promovon rritjen ekonomike, zgjidhjen e problemeve sociale dhe zhvillimin e njohurive. Universitetet që ndikojnë pozitivisht në shoqëri mund të sigurojnë gjithashtu fonde të konsiderueshme nga donatorët dhe qeveria, duke rritur kështu burimet për kërkime dhe investime në arsim cilësor.

#### Indikatorët përmirësojë cilësinë e jetës së këtij objektivi

- **Pozicionimi i UAMD-së si një qendër për zhvillimin ekonomik dhe kulturor** në rajonin e Durrësit dhe më gjërë, duke ofruar ekspertizë dhe ndihmë teknike për bizneset lokale, veçanërisht në sektorin e turizmit, teknologjisë dhe menaxhimit.
- **Promovimi i UAMD-së si një qendër inovacioni dhe zhvillimi teknologjik** përmirësimin e ekonomisë lokale dhe kombëtare.



- **Pozicionimi i UAMD-së si një qendër kërkimi dhe inovacioni** në rajonin e Durrësit, duke u fokusuar në zhvillimin ekonomik lokal dhe rajonal përmes projekteve të aplikueshme dhe inovative.
- **Organizimi i forumeve lokale, kombëtare e ndërkombëtare, konferencave dhe seminareve** që sjellin bashkë studiues, biznesmenë, firma dhe brande të kohës, studentë dhe përfaqësues të industrisë për të diskutuar tendencat e fundit dhe për të promovuar bashkëpunimin dhe arritjet e universitetit.
- **Krijimi i një platforme të hapur** për angazhimin e komunitetit lokal dhe ndërkombëtar në projekte që kanë ndikim shoqëror dhe përfshirje të drejtpërdrejtë me bizneset dhe industrinë.
- **Rol kyç në zhvillimin dhe formësimin e politikave publike.** Universiteti duhet të kontribuojë në diskutimet mbi çështje të rëndësishme sociale dhe ekonomike, dhe duhet të propozojë e të marrë përsipër kërkime që ndihmojnë institucionet shtetërore dhe organizatat publike të marrin vendime të informuara, përmes studimeve dhe kërkimeve, si dhe duhet të ofrojë zgjidhje të bazuara në prova për probleme si varfëria, papunësia, dhe drejtësia sociale në Durrës e më gjerë.
- **Universiteti si një qendër kulturore, artistike dhe sociale** për qytetin dhe sidomos për komunitetin e zonës ku ndodhen godinat e tij, nëpërmjet, shfaqjeve artistike, teatrove, të ftuar, filmave të shfaqur, këshillimit psikologjik dhe terapeutik, këshillimit juridik, ekonomik dhe problemeve të ndryshme që shqetësojnë komunitetin.
- Duhet të forcohet edhe më shumë roli i Qendrës së Edukimit në Vazhdim, në kualifikimet nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të mësuesve jo vetëm në rajonin e Durrësit por dhe më gjerë.
- Krijimi i fondeve publike, për financime të përbashkëta të aktiviteteve të ndryshme në jetën publike, sociale, kulturore dhe ekonomike të rajonit të Durrësit dhe më gjerë, aktivitete këto apo veprimtari me interes të ndërsjelltë, duke rritur vizibilitetin dhe vlerësueshmërinë e universitetit.
- Kthimi i universitetit në një qendër trajnimesh për stafet e bizneseve të ndryshme, për rritjen e cilësisë së shërbimeve që ato ofrojnë dhe rritjen apo forcimin e mërrëdhënieve.
- Organizimi i leksioneve të hapura që janë të aksesueshme për publikun e gjerë dhe grupet e interesuara, duke përfshirë studentët, akademikët, dhe profesionistët e interesuar nga jashtë universitetit. Këto leksione do të janë



## UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

një mundësi për të ndarë njohuri dhe për të diskutuar tema të rëndësishme profesionale, në të gjitha fushat e zhvillimit të shoqërisë, duke rritur këshuta ndikimin dhe dukshmërinë e UAMD-së në shoqërinë më të gjerë. Bashkëpunimi me komunitetin përfshin aktorë të ndryshëm, si prindërit, bizneset, dhe komunitetin përreth universitetit. Ky Plan Strategjik reflekton diskutimet dhe kontributet e aktorëve të brendshëm, me qëllim hapjen e universitetit ndaj komunitetit, rritjen e performancës dhe krijimin e përfitimeve të ndërsjella për studentët, stafin dhe shoqërinë, duke siguruar qëndrueshmëri në afatmesëm dhe afatgjatë.

### Prioriteti 6: Qeverisja dhe trasparenca

Prioriteti strategjik ka si qëllim rritjen e transparencës në vendimmarje, përfshirjen aktive të stafit dhe studentëve, si dhe promovimin e praktikave etike në menaxhim. Përmes një qeverisjeje efektive dhe transparente, Universiteti synon të sigurojë një ambient të qëndrueshëm dhe mbështetës për të gjithë anëtarët e tij.

#### Objektiv 6.1 Rritja e transparencës

Informacioni mbi proceset dhe vendimet e administratës të jetë i aksesueshëm për të gjithë anëtarët e komunitetit akademik, duke promovuar një kulturë të komunikimit të hapur.

##### *Indikatorët për matjen e arritjes së këtij objektivi*

- Numri i dokumenteve administrative të publikuara.
- Organizimi i sesioneve informative të komunitetit akademik dhe studentëve.
- Pyetësor për të vlerësuar perceptimin e transparencës në proceset vendimmarrëse.

#### Objektiv 6.2 Përfshirja e stafit dhe studentëve në vendimmarje

Angazhimi i stafit akademik dhe studentëve në proceset e vendimmarjes për të garantuar që zërat e të gjithëve të dëgjojen dhe të merren parasysh.



- Numri i takimeve konsultative të organzuara përtë diskutuar vendimmarrjet me pjesëmarrjen e stafit dhe studentëve.
- Pjesëmarrja e studentëve dhe stafit në komisione vendimmarrëse.
- Pyetësor përtë matur se sa të angazhuar ndihen ata në proceset e vendimmarrjes.

Objektivi 6.3 Promovimi i etikës dhe përgjegjshmërisë

Të inkurajohet një kulturë e etikës dhe përgjegjshmërisë në të gjitha nivelet e veprimtarisë së universitetit, duke përfshirë trajnime dhe sesione informuese për stafin dhe studentët.

- Numri i trajnimeve të organzuara mbi etikën dhe përgjegjshmërinë për stafin dhe studentët.
- Pyetësor përtë matur perceptimin e stafit dhe studentëve mbi nivelin e etikës dhe përgjegjshmërisë në universitet.



## Monitorimi i planit të zhvillimit

Monitorimi i Planit të Zhvillimit Strategjik është një proces i rëndësishëm që siguron përputhshmérinë e aktiviteteve me objektivat e përcaktuara dhe vlerësimin e arritjeve e rezultateve të pritura. Ai përfshin mbledhjen e të dhënave periodike, analizën e indikatorëve të performancës dhe përpunimin e këtyre të dhënave për të bërë ndryshimet e nevojshme në strategji. Nëpërmjet monitorimit, mund të identifikohen çështjet që ndikojnë në përbushjen e objektivave dhe të ndërmerren veprimet e duhura për të arritur rezultate më të mira dhe për të siguruar përputhshmérinë e vazhdueshme me priorititet strategjike aktuale.

Monitorimi i Planit të Zhvillimit Strategjik bëhet kryesisht nga Rektorati, i cili ka përgjegjësinë për mbikëqyrjen e zbatimit të objektivave strategjikë të universitetit dhe siguron që aktivitetet dhe politikat janë në përputhje me drejtimet e përcaktuara në planin e zhvillimit. Rektorati është përgjegjës për vlerësimin e progresit të realizimit të objektivave, duke analizuar se si objektivat janë implementuar në përputhje me strategjinë dhe planifikimin afatgjatë të universitetit. Ai nevojshme, të ndërmerren masa për të adresuar mangësitë e mundshme. Ky proces përfshin mbledhjen e të dhënave, analizën e tyre si dhe raportimet përkatëse me qëllim arritjen e objektivat në kohë dhe me cilësi.

## Rishikimi dhe përmirësimi i planit

Procesi i hartimit të planit u bazua në një analizë të hollësishme të situatës aktuale, duke përfshirë performancën akademike, kapacitetet administrative dhe mundësitë e zhvillimit.

Kjo analizë u mbështet në konsultime të vazhdueshme me organet dhe autoritetet drejtuese të UAMD-së, njësitë përbërëse të universitetit, stafin akademik, studentët dhe partnerët institucionalë.

Rishikimet e mëvonshme të këtij plani do të janë pjesë e një procesi dinamik dhe të qëndrueshëm për të siguruar që prioritetet strategjike të pasqyrojnë jo vetëm nevojat e komunitetit të UAMD-së, por edhe sfidat dhe mundësitë që lindin nga zhvillimet e reja.



## Anekse

### Planet e veprimit dhe të zbatimit

PRIORITETI STRATEGJIK	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORËT KOHORE	AFATET KOHORE	PERSONAT PËRGJEGJËS	MONITORIMI/VLERËSIMI REALIZIMI
1. Mësimdhënia dhe studentët	Objektivi 1.1 Unifikimi i 1. kurrikulave - Zgjerimi i 2. ofertës akademike në gjuhë të huaja.			Dekanatet, njësítë përgjegjëse	P.Sh 80%
	Objektivi 1.2 Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimi i kompetencave të pedagogëve			Dekanatet, njësítë përgjegjëse	
	Objektivi 1.3 Integrimi i teknologjisë në mësimdhënie mësim i kombinuar			Dekanatet, njësítë përgjegjëse	



**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**



PRIORITETI STRATEGJIK	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORËT AFATET KOHORE	PERSONAT PËRGJEGJËS	MONITORIMI/VLERËSIMI REALIZMI
Objektivi 1.4 - Mikrokreditet, afatshkurtra dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës	1.4 - kurset		Dekanatet, njësitë përgjegjëse	Rektorati
Objektivi 1.5 Zhvillimi i aftësive të buta si bazë për suksesin personal dhe profesional			Dekanatet, njësitë përgjegjëse	Rektorati
Objektivi 1.6 Zhvillimi i një mjetisi mësimor gjithëpërfshirës e mbështetës			Dekanatet, njësitë përgjegjëse	Rektorati
Objektivi 1.7 Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore shkencore me financim nga UAMD			Dekanatet, njësitë përgjegjëse	Rektorati



## UNIVERSITETI "ALEKSANDER MOISIU" DURRËS



**STARS**

Strategic alliance  
for regional transition

PRIORITETI STRATEGJIK	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORËT AFATET KOHORE	PERSONAT PËRGJEGJËS	MONITORIMI/VLERËSIMI	REALIZIMI
	Objektivi 1.8 Punësimi i studentëve ekselentë dhe rritja e bashkëpunimit me alumni		Dekanatet, njësitë përgjegjëse	Rektori	

PRIORITETI STRATEGJIK	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORËT AFATET KOHORE	PERSONAT PËRGJEGJËS	MONITORIMI/VLERËSIMI	REALIZIMI
2. Kërkimi shkencor dhe inovacioni	Objektivi 2.1 Rritja e cilësisë së kërkimit 1. shkencor Objektivi 2.2 Sigurimi i impaktit të kërkimit shkencor në jetën e vendit		Dekanatet, njësitë përgjegjëse	Rektori	



**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**



PRIORITETI STRATEGJIK	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORËT	AFATET KOHORE	PERSONAT PËRGJEGJËS	MONITORIMI/VLERËSIMI	REALIZIMI
	Objektivi 2.3 Fushizimi i lirhjeve ndërkombëtare të UAMD			Dekanatet, njësitë përgjegjëse	Rektori	
	Objektivi 2.4 Ngritja e një sistemi të saktë e të qëndrueshëm të vlerësimit performances së Kërkimit Shkencor			Dekanatet, njësitë përgjegjëse	Rektori	

PRIORITETI STRATEGJIK	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKASTORËT	AFATET KOHORE	PERSONAT PËRGJEGJËS	MONITORIMI/VLERËSIMI	REALIZIMI
3. Ndërkombëtarizimi	Objektivi 3.1.1. Promovimi i prioritetit të ndërkombëtarizimit			Dekanatet, njësitë përgjegjëse	Rektorati	



PRIORITETI STRATEGJIK	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKASTORËT	AFATET KOHORE PËRGJEGJËS	PERSONAT MONITORIMI/VLERËSIMI	REALIZIMI
në të gjitha aktivitetet e universitetit					
Objektivi 3.2 Rritja e kapaciteteve të stafeve akademike		Dekanatet, njësitë përgjegjëse		Rektorati	
Objektivi 3.3 Aleanca STARS EU		Dekanatet, njësitë përgjegjëse		Rektorati	
Objektivi 3.4 Zgjerimi i ofertës akademike në gjuhë të huaja		Dekanatet, njësitë përgjegjëse		Rektorati	
Objektivi 3.5 Rritja e numrit të projekteve kërkimore ndërkombëtare		Dekanatet, njësitë përgjegjëse		Rektorati	



**UNIVERSITETI "ALEKSANDER MOISIU" DURRËS**

PRIORITETI STRATEGJIK	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKASTORËT	AFATET KOHORE	PERSONAT PËRGJEGJËS	MONITORIMI/VLERËSIMI	REALIZIMI
	Objektivi 3.6 Rritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i mëtejshëm i strukturave mbështetëse përmirësimi i ndërkombëtarizimin			Dekanatet, njësitë përgjegjëse	Rektorati	
PRIORITET STRATEGJIKE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKASTORËT	AFATET KOHORE	PERSONAT PËRGJEGJËS	MONITORIMI/VLERËSIMI	REALIZIMI
4. Infrastruktura dhe burimet njerëzore	Objektiv 4.1 Rekrutimi dhe ruajtja e profitit të stafit Objektiv 4.2 Përmirësimi i infrastrukturës,	4.1.1.		Dekanatet, njësitë përgjegjëse	Rektorati	



## UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS



PRIORITET STRATEGJIK	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKASTORËT	AFATET KOHORE	PERSONAT PËRGJEGJËS	MONITORIMI/VLERËSIMI	REALIZIMI
	shërbimeve dhe logistikës					
Objektiv 4.3	Transformimi Dixhitali UAMD-së			Dekanatet, njësitë përgjegjëse		
				Rektorati		
PRIORITET STRATEGJIK	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORËT	AFATET KOHORE	PERSONAT PËRGJEGJËS	MONITORIMI/VLERËSIMI	REALIZIMI
5. Komuniteti dhe përgjegjësia	Objektivi Raportet Universiteti komunitetin qytetarëve	5.1. 1.		Dekanatet, njësitë përgjegjëse		
	Objektivi Bashkëpunimi Univeristetit dhe	5.2		Dekanatet, njësitë përgjegjëse		
				Rektorati		



**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**

PRIORITET STRATEGJIK	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORËT	AFATET KOHORE	PERSONAT PËRGJEGJËS	MONITORIMI/VLERËSIMI	REALIZIMI
Komunitetit biznesit	të					
Objektivi 5.3 Rritja e Ndikimit Social dhe Ekonomik të UAMD-së				Dekanatet, njësitë përgjegjëse		
PRIORITET STRATEGJIK	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORËT	AFATET KOHORE	PERSONAT PËRGJEGJËS	MONITORIMI/VLERËSIMI	REALIZIMI
6. Qeverisja dhe transparencë	Objektiv 6.1 Rritja e transparencës	1.		Dekanatet, njësitë përgjegjëse		
	Objektiv 6.2 Përfshirja e stafit dhe studentëve në vendimarrje			Dekanatet, njësitë përgjegjëse		



## UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS



PRIORITET STRATEGJIKE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORËT KOHORE	AFATET PËRGJEGJËS	PERSONAT PËRGJEGJËS	MONITORIMI/VLERËSIMI	REALIZIMI
	Objektivi 6.3 Promovimi i etikës dhe përgjegjshmërisë			Dekanatet, njësítë përgjegjëse	Rektorati	